

**URDHËR**  
**Nr. 439/1, datë 31.12.2019**

**PËR NJË SHITESË NË URDHRIN E MINISTRIT TË FINANCAVE DHE  
EKONOMISË NR. 439, DATË 26.12.2019 “PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË  
FORMULARËVE TË APLIKIMIT VETËM *ON-LINE*, TË STANDARDIZUAR NGA  
AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA),  
PËR REGJISTRIMIN DHE LICENCIMIN E BIZNESIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionin e Këshillit të Ministrave; pikës 4, të nenit 16, të ligjit nr. 131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” dhe urdhrit të Kryeministrit nr. 153, datë 25.11.2019, “Për marrjen e masave për rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve *on-line* nga data 1.1.2020” ,

**URDHËROJ:**

1. Titulli i urdhrit ndryshon si vijon:  
“Për miratimin e përdorimit të formularëve të aplikimit vetëm *on-line*, për regjistrimin dhe licencimin e biznesit”.
2. Pika 1, ndryshon si vijon:  
“1. Miratimin e përdorimit të formularëve të aplikimit vetëm *on-line*, për regjistrimin dhe licencimin e biznesit”.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Biznesit për zbatimin e këtij urdhri.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE  
DHE EKONOMISË  
**Anila Denaj**